



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 8, nenit 3a, 3b, 3c dhe të nenit 6 të Ligjit mbi eksproprijimin, Gazeta zyrtare e Kosovës nr. 21/76, 45/86 dhe nr. 25/89, të nenit 9.2 të Ligjit për rrugët nr. 2003/11, të nenit 3 të Rregullores mbi qeverisjen e komunave të Kosovës 2000 /45 dhe të nenit 19 të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.10.2005 merr

V E N D I M
PËR SHPALLJEN E PJESËS SË NGASTRËS KADASTRALE NR. 2401, ZONA
KADASTRALE PRISHTINË, E EVIDENCUAR NË FLETËN POSEDUESE NR. 6806
TOKË ME INTERES TË PËRGJITHSHËM

Neni 1

Miratohet Vendimi për shpalljen e pjesës së ngastrës kadastrale nr. 2401, zona kadastrale-Prishtinë, e evidencuar në fletën poseduese nr. 6806, tokë me interes të përgjithshëm, me qëllim të realizimit të Planit urbanistik dhe ndërtimin e rrugës në kuadër të lagjes “Vreshtrat”.

Neni 2

Pjesa e ngastrës kadastrale, e përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi , përfshinë tokën brenda kufijve të trasesë rrugore, të caktuar me planin e infastrukturës rrugore si pjesë e Planit detal urbanistik të lagjes “ Vreshtrat”, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, të shpallur në Gazetën zyrtare nr. 35/ 84 dhe nr. 38 / 86, i cili paraqet pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

Neni 3

Fillohet procedura e eksproprijimit të tokës, të shpallur me interes të përgjithshëm sipas këtij Vendimi.

Neni 4

Procedura e eksproprijimit të tokës, të përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi, do të zhvillohet nga Drejtorati i Financave dhe i Pronës i Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë i Komunës së Prishtinës do të kryejë veprimet e tij procedurale nga përgjegjësia e tij e caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.110-24904 më 28.10.2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri